



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 20.07.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.07.2022, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik NTP “Fidani-L”( Lulzim Beqiraj B.I. ) & “Fidani Beton”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe sanimi i parqeve “ , Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve ekonomik “NTP “Fidani-L”( Lulzim Beqiraj B.I. ) & “Fidani Beton”, e dt.15.07.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi dhe sanimi i parqeve “ , Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, kundër NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 13.07.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 13.07.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## A r s y e t i m

Me dt.15.07.2022, Grupi i Operatorëve ekonomik “NTP “Fidani-L”( Lulzim Beqiraj B.I. ) & “Fidani Beton”, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “Ndërtimi dhe sanimi i parqeve “, Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.07.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Grupi i Operatorëve ekonomik “NTP “Fidani-L”( Lulzim Beqiraj B.I. ) & “Fidani Beton”, të dt.15.07.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se sqarimet e ofruara nga Grupi i Operatorëve Ekonomik “Berisha Com”sh.p.k. & “JOOS & KRASNIQI- BAZË” sh.p.k., janë të mjaftueshme dhe se pretendimet e Grupit të Operatorëve ekonomik ankues, janë të pa bazuara, prandaj vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës